

Thirrje për Aplikime Global Supplementary Grant Program (GSGP 2011 – 2012)

Programi i Bursave të **Fondacioneve të Shoqërisë së Hapur** njofton hapjen e aplikimeve për bursat Global Supplementary Grant Program (GSGP) për vitin akademik 2011 – 2012. GSGP ofron bursa plotësuese për vende nga Europa Lindore dhe Qendrore, Ish-Bashkimi Sovjetik dhe Mongolia, Lindja e Mesme/Afërt dhe Azia Jugore. Qëllimi i këtij programi është të ndihmojë studentët të kualifikuar që janë duke ndjekur studime doktorature në **Shkencat Humane dhe Sociale** në një universitet të akredituar në Azi, Australi, Europë, Lindje e Mesme/Afërt dhe Amerikën e Veriut.

Kriteret e përzgjedhjes

Programi i Bursave GSGP është i vlefshëm për qytetarë të vendeve: Shqipëri, Afganistan, Armeni, Azerbaixhan, Bjellorusi, Bosnje - Hercegovinë, Kroaci, Egjipt, Gjeorgji, Irak, Jordani, Kazakistan, Kosovë, Kirgizstan, Liban, Maqedoni, Moldavi, Mongoli, Mali i Zi, Nepal, Palestinë, Fedarta Ruse, Serbi, Siri, Taxhakistan, Turkmenistan, Ukrainë dhe Uzbekistan.

Nuk mund të aplikojnë për këtë program studentët që ndjekin studime doktorature në fushën e shkencave mjekësore, fizikës, kimisë, teknikës, ekonomisë, shkenca natyrore si dhe arte.

Bursat GSGP jepen vetëm për studime doktorature. Studentët e pranuar në një program masteri me qëllimin për të vazhduar më tej me studimet e tyre por që nuk janë të pranur konkretisht në një program PhD nuk mund të konsiderohen për këto bursa.

Ju lutem kini parasysh se ky është një Program Plotësues, pra nuk ofron financim të plotë. Aplikantët duhet të vërtetojnë se disponojnë mjete financiare shtesë nga burime të tjera.

Aplikimi

Për më tepër detaje në lidhje me programin dhe udhëzimet për aplikim do t'i gjeni në Formularin e Aplikimit të 'GSGP 2011-2012'. Për të lexuar thirjen për aplikime në variantin pdf, klikoni këtu.

Formularin mund ta gjeni duke klikuar këtu:

- Udhëzime dhe Formulari i Aplikimit – Europë.
- Udhëzime dhe Formulari i Aplikimit – Amerika e Veriut.

Aplikantët mund të aplikojnë edhe online duke përdorur aplikimin online (The Online Application System (OAS)) tek faqja: <http://www.soros.org/grants/oas>.

Afatet e Aplikimit

Për studentët që ndjekin studimet e doktoraturës në një nga vendet: *Azi, Australia, Amerika e Veriut, Lindje e Mesme*, afati është **data 1 Prill 2011**.

Për studentët që ndjekin studimet Phd në **Europë**, afati është: **31 Maj 2011**.

Aplikimet për **GSGP Amerika e Veriut**, etj mund të dërgohen në New York te adresa si më poshtë:

Aplikimet për **GSGP Europë** mund të dërgohen në Londër te adresa si më poshtë:

Të dy llojet e aplikimeve (Amerikë e Veriut dhe Europë) mund të dërgohen gjithashtu edhe te adresa e Fondacionit Soros, Tiranë.

Global Supplementary Grant Program –Amerika e Veriut

Open Society Institute
1700 Broadway, 17th Floor
New York, NY 10019
U.S.A.

Global Supplementary Grant Program - Europe

Open Society Foundation
Network Scholarship Programs
Cambridge House
100 Cambridge Grove
London W6 0LE
United Kingdom

**Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë
Rr"Qemal Stafa", P.120/2, Tiranë
Tel: 2234621/2248213, email: ibakshevani@osfa.soros.al**